

AUTORË

(I)

Autorë ortodoksë

- Andrea i Kretës*, shenjtor (660 -740 përafërsisht): peshkop grek dhe himnograf, poet i Kanonit të Madh që gjendet në librin e kreshmëve të mëdha, *Triodi*.
- Andoni i Egjyptit*, shenjtor (251 - 356 përaf.): heremit dhe udhëçelës i jetës murgjërore; *Jetërshkrimi*, nga shën Athanasi, përkthyer në anglisht nga R. C. Gregg, *The Classics of Western Spirituality* (Paulist Press, New York, 1980).
- Antoni (Khrapovitsky)*, mitropolit i Kievës (1863 - 1936): teolog rus, kryepeshkopi i parë i Kishës Ortodokse Ruse të Diasporës. Autor i veprës: *Rrëfime*, një seri leksionesh mbi Misterin e Pendesës (Jordanville, N.Y., 1975 etj.).
- Afrati* (fillimi i shek. IV): At sirian.
- Athanasi i Aleksandrisë*, shenjtor (293 - 373 përaf.) At grek, kundërshtar i Arianizmit.
- Augustini*, shenjtor (354 - 430): peshkop i Hipponës, At latin, autor i *Rrëfimeve*.
- Beausobre, Julia de* (Lady Namier) (1893 - 1977): shkrimtare ruse e veprës *Gruaja që nuk i dilte Shpirti* (Londër 1938) dhe *Dhembje krijuese* (Londër 1940).
- Berdyaev, Nicolas* (1874 - 1948): filozof fetar rus, autori i librit *Destinacioni i njeriut* (Londër 1937), *Domethënia e krijimit artistik*, (Londër 1955), etj.
- Bulgakov, Sergei*, kryepriift (1871 - 1944), teolog rus, dekan i Institutit Teologjik Ortodoks të Shën Sergjit në Paris, autor i veprës *Kisha Ortodokse* (Londër 1935).
- Shih I. Pain dhe N. Zernov, *Një antologji nga veprat e Bulgakovit* (Londër 1976).
- Clement, Oliver* (lindi më 1921): Shkrimtar ortodoks frëng; shkruajti *Questions sur l'homme* (Paris 1972), *The spirit of Solzhenitsyn* (Londër,1976), etj.
- Colliander, Tito* (lindi 1904): anëtar i Kishës Ortodokse të Finlandës, shkrimtar dhe mësues. Shkroi veprën *The Way of the Ascetics* (Londër 1960).
- Diadohu i Fotikës*, shenjtor (mesi i shek.V): shkrimtar spiritual grek.
- Dionis Areopajiti*, shenjtor (rreth vitit 500): teolog mistik grek.
- Dimitri i Rostov-it*, shenjtor (1651 - 1709): peshkop rus, i mirënjohur si predikator dhe shkrimtar.
- Dostoevsky, Feodor* (1821 - 1881): shkrimtar rus. Figura e stareç Zosimait, në romanin *Vëllezërit Karamazov*, bazohet pjesërisht tek shën Tihoni i Zadoniskut dhe tek shën Amvrosi i Optinës.
- Efrem, Siriani*, shenjtor (306 - 373 përaf.): At sirian.
- Elchaninov, Alexander*, kryepriift (1881 - 1934): priift i rusëve të diasporës në Francë, autor i librit, *Ditar i një priifti rus* (Londër 1967).
- Eriugena, John Scotus* (810 - 877 përaf.): dijetar irlandez dhe filozof.
- Ermas* (shek II): autor i veprës *Bariu*.

Evagri i Pondit (346 - 399): murg në Sketën e Egjyptit, shkrimtar asketik dhe mistik.

Evdokimov, Paul (1901 - 1970): teolog rus, profesor në Institutin Ortodoks Teologjik të Shën Sergjit në Paris; autor i veprës *Ortodoksia* (Paris, 1959), *Femra dhe shpëtimi i botës* (New York 1994), etj.

Filareti (Drozdov), mitropolit i Moskës (1782 - 1867): hierarku më i shquar rus i shek. XIX; predikator dhe teolog, i njohur sot për *Ligjërimet* e tij.

Fjalë të urta nga Etërit e shkretëtirës: rrëfime dhe thënie të murgjëve të parë, veçanërisht në Egjypt. (shek. IV - V), në greqisht *Jerondikon*.

Grigor Teologu, shenjtor (329 - 389): i njohur në perëndim me emrin Grigor Nazianzini, një nga të tre “Hierarkët e Mëdhenj”.

Ignatii (Brianchaninov), peshkop (1807 - 1867): shkrimtar spiritual rus. Shkroi *Mbi Lutjen e Jezuit* (Londër 1952).

Irineu i Lionës, shenjtor (130 - 200 përaf.) At grek i lindur në Azi të vogël; u njoh me shën Polikarpin e Smirnës; më vonë peshkop i Lionës.

Isak Siriani, shenjtor (fundi i shek VII): peshkop i Ninevisë, At sirian.

Isaku i Sketës, shenjtor (vdiq në 489): murg grek, fillimisht në Egjypt dhe më vonë në Palestinë.

Joani i Damaskut, shenjtor (675 - 749): At grek, himnograf, kundërshtar i ikonoklastëve.

Joan Gøjarti (Krisostomi), shenjtor (347 - 407 përaf.), Kryepeshkop i Kostandinopojës, At grek, një nga të tre “Hierarkët e Mëdhenj”. Një nga veprat e tij më të njohura është *Mbi priftërinë*.

Joani i Kronstandit, shenjtor (1829 - 1908): prift rus, anëtar i klerit famullor të martuar.

Joani i Shkallës, shenjtor (? 569 - ? 649): shkrimtar spiritual grek, igumen i Sinait, i cili shkroi veprën e mirënjohur *Shkalla e ngjitjes hyjnore*.

Joaniku, shenjtor (754 - 846 përaf): asket grek, murg në malin Olimpos të Azisë së Vogël, kundërshtar i ikonoklastëve.

Kalistos Katafigiotis (? shek XIV): shkrimtar spiritual grek.

Khomiakov, Aleksei (1804 - 1860): teolog rus, udhëheqës i lëvizjes slavofile.

Klementi i Aleksandrisë, shenjtor (150 - 215 përaf): At grek, autor i veprës *Nxitje grekëve* etj.

Leo i Madh, shenjtor (vdiq në 461): papë i Romës.

Leondi i Qipros, shenjtor (shek. VI - VII): At grek, mbrojtës i ikonave të shenjta.

Lossky, Vladimir (1905 - 1958): teolog rus; punoi në Paris.

Makari i Egjyptit, shenjtor (300 - 390 përaf): murg i Sketës. *Ligjërimet* në greqisht që quhen nga tradita si të tijat, tani konsiderohen se nuk janë vepër e tij dhe se u shkruan në Siri, në fund të shek. IV, ose fillim i shek. V.

Makari i Optinës (1788 - 1860): stareç rus.

Maksim Konfessori, shenjtor (580 - 662): At grek.

Maria e Normanby-t, igumene (1912 - 1977) (me emrin e mëparshëm Lydia Gysi): murgeshë ortodokse, me origjinë gjermano - zviceriane; ndërtoi manastirin e Fjetjes së Hyjlindëses (Normanby, Yorkshire).

Maria e Parisit (1891 - 1945), igumene (me emrin e mëparshëm Elisaveta Skobtsova): ruse, fillimisht e martuar dhe më vonë murgeshë; nga fundi i jetës së saj iu përkushtua punës sociale në Francë; vdiq në kamp përqëndrimi nazist në Ravensbruck.

Mark Murgu, shenjtor (fillimi i shek. V): shkrimtar spiritual grek.

Mujore (Μετάρη): vepër liturgjike ortodokse me 12 vëllime (një për çdo muaj), që përmban tekstet e të kremteve të palëvizshme të vitit kishtar.

Nazari i Valamos (1735 - 1809): *stareç*, igumen i manastirit të Valamos në Finlandë.

Nikolla Kavalas, shenjtor (1322 - 1396 për. af.), teolog bizantin.

Nili i Angjirës, shenjtor (fillim i shek V): quhet gjithashtu (gabimisht) Nili i Sinaït: shkrimtar asketik grek.

Origjeni, (185 - 254 për. af.). At grek; punoi kryesisht në Aleksandri.

Polikarpi, shenjtor (69 - 155 për. af.): peshkop i Zmirnës, martir; në moshë të re u njoh me shën Joan Ungjillorin.

Qirili i Aleksandrisë, shenjtor (vdiq më 444): At grek i mirënjohur për devocionin e tij ndaj Virgjëreshës Mari, të cilën e nderoi me titullin “Hyjlindëse”.

Qirili i Jerusalemit, shenjtor (315 - 386 për. af.): At grek, autor i veprës *Mësime*.

Romano Melodisti, shenjtor, (fillim i shek VI): me origjinë siriane, autor i shumë himneve në greqisht - *Kondakia*.

Rozanov Vasili (1856 - 1919), filozof fetar rus.

Schemman, Alexander, kryepriift (1921 - 1983); teolog i diasporës ruse, dekan i Seminarit ortodoks të shën Vladimirit në New York.

Serafimi i Sarovit, shenjtor (1759 - 1833): murg rus dhe *stareç*, më i famshmi nga shenjtorët e rinj rusë. *Bashkëbisedim me Nicolas Motovilov* është burimi kryesor për jetëshkrimin e tij dhe më tepër për mësimet e tij.

Sergius i Radonezh-it, shenjtor (1314 - 1392 për. af.): shenjtori më i madh kombëtar i Ruisë. Themelues dhe igumeni i manastirit të Trinisë së Shenjtë, Zagorsk.

Simeoni, Teologu i Ri, shenjtor (949 - 1022): shkrimtar asketik dhe mistik grek; shkroi *Himnet e dashurive hyjnore*.

Sinesi i Kirinisë (370 - 417 për. af.), peshkop i Ptolemaidës, At grek.

Sherrad Philip (1922 -), teolog ortodoks.

Staniloae, Dumitru, kryepriift (1903 - 1994): teolog rumun, botues i përkthimit të *Filokalisë* në rumanisht (tetë vëllime).

Triodi, libër liturgjik ortodoks, që përdoret gjatë periudhës së dhjetë javëve para Pashkës.

Tikhon Zadonsk-it, shenjtor (1724 - 1783): peshkop i Voronezhit, shkrimtar spiritual rus dhe predicator.

Theofani i Ngjuar, shenjtore (1815 - 1894): peshkop, shkrimtar spiritual rus.
Theofili i Antiokisë (fundi i shek. II): teolog grek, njëri prej *Apologjistëve*.
Theokliti i Dionisiut, At: murg grek bashkëkohës në Athos.
Varsanufi, shenjtore (fillimi i shek. VI): murg i Gazës; eremit dhe at shpirtëror.
Vasili i Madh, shenjtore (330 - 379 përfaq): kryepeshkop i Qesarisë, At grek, një nga të tre “Hierarkët e Mëdhenj”, vëlla i shën Grigorit të Nisës.
Vladimir Monomakh, princ i Kievës (1053 - 1125): sundimtar rus.
Way of Pilgrim, (Udha e një shtegëtarit), vepër autobiografike anonime, e datuar nga mesi i shek. XIX; rrëfen endjet e një pelegrini rus, i cili ushtrohet në thënjen e vazhdueshme të Lutjes së Jezuit.
Zaharia, At (1850 - 1936): stareç në manastirin e Trinisë së Shenjtë dhe Shën Sergjit të Zagorsk -it, në Rusi.

(II)

Autorë jo ortodoksë

Boehme, Jacob (1575 - 1624): Luterian gjerman, shkrimtar mistik. Shkruajti veprën *Udha përdrejt Krishtit*.
Eckhart, Meister (1260 - 1327 përfaq): Dominikan gjerman, shkrimtar mistik.
Julian e Noruich-ut, The Lady (p.1342-mbas 1413): shkrimtare mistike angleze.
Lau, Uilliam (1686 - 1761): prift anglikan, shkrimtar spiritual.
Leuis, C.S. (1898 - 1963), anglikan, autor i librit *Problemi i dhimbjes* (Londër 1940) etj..
Libri i të varfërve nga mendja, tekst mistik gjerman i shek. XIV.
Merton, Thomas (1915 - 1968): shkrimtar kistersian katolik, në SHBA.
Mugëtira e padijes (Cloud of unknowing): tekst mistik anglikan i shek XIV, i ndikuar thellë nga shën Dionis Areopagiti.
New Clairvaux, murg, autor i veprës *Nuk më përket*, New York, 1979.
Newman, John Henry, kardinal (1801 - 1890): udhëheqës i anglikanëve traktarianë (filokatolikë), u bë katolik në 1845; shkruajti *Arianët e shek IV* (1883) dhe vepra të tjera mbi Etërit e Kishës.
Suso, Henry (1295 - 1366 përfaq): dominikan gjerman, shkrimtar mistik.
Thomson, Francis (1859 - 1907): poet katolik.
Traherne, Thomas (1636 - 1674 përfaq): poet mistik anglez dhe shkrimtar spiritual; shkruajti veprën, *Qindra përsiatje*.
Tyrrel, George (1861 - 1909): shkrimtar katolik i lidhur me *Lëvizjen moderne*.

